



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 74

Tiranë – E hënë, 8 maj 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 4.5.2023	Për transferimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Lezhë të një pjese të pronës nr. 983, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4010”, me vendndodhje në Gjadër, Lezhë, pjesë e pasurisë nr. 420/1, zona kadastrale 1716, dhe për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003, të ndryshuar, dhe nr. 414, datë 11.7.2007, të ndryshuar.....	8503
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 9, datë 28.4.2023	Për kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me produkte të mbrojtjes së bimëve.....	8506
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 11, datë 2.5.2023	Mbi materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë në kontakt me ushqimin.....	8508
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 55, datë 27.4.2023	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të shitjes dhe depozitimit të të ardhurave nga shitja e pasurive të sekuestruara, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit.....	8511
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 66, datë 28.4.2023	Për delegim kompetence.....	8515
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 431, datë 3.5.2023	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëpartiake të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Shkodër, z. Frrok Gjini.....	8516
Vendim i Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 4, datë 27.4.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	8517

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 108/3, datë 4.5.2023	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Zgjerimi i varrezave publike të Njesisë Administrative Perondi, Fshati Tapi, Kuçovë”.....	8548
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 426/4, datë 4.5.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë).....	8550

**VENDIM****Nr. 283, datë 4.5.2023**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA
LEZHË TË NJË PJESE TË PRONËS
NR. 983, ME EMËRTIM “REPARTI
USHTARAK NR. 4010”, ME
VENDNDODHJE NË GJADËR, LEZHË,
PJESË E PASURISË NR. 420/1, ZONA
KADASTRALE 1716, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMET E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 515,
DATË 18.7.2003, TË NDRYSHUAR, DHE
NR. 414, DATË 11.7.2007, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “g”, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Lezhë të një pjese të pronës nr. 983, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4010”, me vendndodhje në Gjadër, Lezhë, pjesë e pasurisë nr. 420/1, zona kadastrale 1716, me sipërfaqe 5 000 (pesë mijë) m², e llojit “truall”, dhe sipërfaqe 37.6

(tridhjetë e shtatë pikë gjashtë) m², e llojit “ndërtesë”, sipas formularit të inventarizimit dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim për ta përdorur për realizimin e nevojave të saj për varreza publike.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 414, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës”, të ndryshuar.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 hiqet nga prona me nr. rendor 983.

4. Bashkisë Lezhë i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Lezhë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE Pjese e Prones Nr.983 "Rep. Usht. 4010", Gjader, Lezhe (Sip. dhe objekti per kalim ne pronesi nga MM tek Bashkia Lezhe)						
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPERISE/MM FA		DATE: 20.04.2023		QELIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: LEZHE DVASHK/ZVASHK: LEZHE ZONA KADASTRALE: 1716 NUMRI PASURISE: 420/1 INDEX HARTE: K-34-76-(84-C) TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE= 1162802 m ² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=14848.45 m ² NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____						
X 466599 Y 4638663		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE			X 467086 Y 4638663	
SHPJEGUES KUFIRI I SIPERFAQES DHE OBJEKTI (RRENOJE) PER TRANSFERIM BASHKISE LEZHE SIPERFAQJA E PERGJITHSHME E TRUALLIT PER TRANSFERIM PJESE E PASURISE 420/1 = 5000.0 m ²						



Bashkia : Lezhe Identifikoi: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Majlinda Miloti Administratori i Nj. Administrative Dajç Supervizori: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pjerin Ndreu Kryetar Bashkie Lezhe Aprovoni: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)										
Fusha e perdorimit te Prones: Sherbim funeral										
A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	1716 K-34-76 (84-C)	420/1	Truall ndertese	Per Varreza Publike Fshati Dajç, Nj Adm Gjader Bashkia Lezhe	5000	37.6	Sherbim Funeral	Bashkia Lezhe	Bashkia Lezhe	11
Siperfaqja prej 5000 m2 eshte pjese e pasurise 420/1 e inventarizuar nga MM me VKM 515/2003, me numer rendor 983 me emertimin "Rep Usht 4010 Gjader". Siperfaqja prej 37.6 m2 eshte rrenoje sipas shenimeve te Ministres se Mbrojtjes. Prona 983, referuar regjistrimit kadastral perbehej nga disa pasuri, dhe gjate proc te regjistrimit dhe leshimit te certifikates se regjistrimit jane bashkuar pasurite duke mare nje numer pasurie 420/1, per pronen me nr rendor 983. Referuar fragmentit te hartes, siperfaqja prej 5000 m2, ka qene pjese e pasurise 95/11, zk 1716.										



UDHËZIM

Nr. 9, datë 28.4.2023

**PËR KRITERET TEKNIKE TË MJETEVE
DHE MAKINERIVE, TË CILAT
PËRDOREN PËR TRAJTIMET ME
PRODUKTE TË MBROJTJES SË BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 7, të nenit 23, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në nenin 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim.

Në këtë udhëzim, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

“*Makineri për aplikimin e pesticideve*” është makineria e përcaktuar specifikisht për aplikimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, sipas kuptimit të pikës 18, nenit 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar. Këto makineri shërbejnë për kryerjen e spërkatjes së produkteve për mbrojtjen e bimëve.

2. Të përgjithshme

Prodhuksi i makinerive për aplikimin e pesticideve ose përfaqësuesit e tij të autorizuar duhet të sigurojnë që të kryhet një vlerësim nga rreziqet e ekspozimit të paqëllimshëm të mjedisit ndaj pesticideve, në përputhje me procesin e vlerësimit dhe reduktimit të riskut.

Prodhuksi i makinerisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë që është kryer një vlerësim risku, me qëllim përcaktimin e kërkesave të shëndetit dhe sigurisë që zbatohen për makinerinë. Më pas, makineria të projektohet dhe ndërtohet duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit të rrezikut.

Me procesin e përsëritur të vlerësimit dhe reduktimit të riskut të përmendur më sipër, prodhuksi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet:

a) të përcaktojë kufijtë e makinerisë, të cilat përfshijnë përdorimin e synuar dhe çdo keqpërdorim të arsyeshëm të parashikueshëm të tij;

b) të identifikojë rreziqet që mund të krijohen nga makineria dhe situatat e rrezikshme të shoqëruara;

c) të vlerësojë risqet, duke marrë parasysh ashpërsinë e dëmtimit të mundshëm ose dëmtimit të shëndetit dhe probabilitetin e shfaqjes së tij;

ç) të vlerësojë risqet, me synimin për të përcaktuar nëse kërkohet reduktimi i riskut, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi;

d) të eliminojnë rrezikun ose zvogëlojnë riskun që lidhen me këto rreziqe duke zbatuar masat mbrojtëse, sipas rendit të prioriteteve të dhëna më poshtë:

i. të eliminojë ose të zvogëlojë risqet sa më shumë që të jetë e mundur duke projektuar dhe ndërtuar makineri në thelb të sigurta;

ii. të marrë masat e nevojshme mbrojtëse në lidhje me risqet që nuk mund të eliminohen;

iii. të informojë përdoruesit për rreziqet e mbetura, për shkak të ndonjë mangësie të masave mbrojtëse të adoptuara, të përcaktojë nëse kërkohet ndonjë trajnim i veçantë dhe të specifikojë ndonjë nevojë për të siguruar pajisje mbrojtëse personale.

Makineria për aplikimin e pesticideve të projektohet dhe ndërtohet duke marrë në konsideratë rezultatet e vlerësimit të rrezikut të përmendur më lart në mënyrë që makineria mund të punojë, të rregullohet dhe mirëmbahet pa ekspozim të paqëllimshëm të mjedisit ndaj pesticideve. Rrjedhja duhet të parandalohet në çdo kohë.

3. Kontrolli dhe monitorimi

Kontrolli, monitorimi dhe ndalimi i menjëhershëm i aplikimit të pesticideve nga pozicionet e punës duhet të jetë e mundur të kryhen me lehtësi dhe saktësi.

4. Mbushja dhe zbrazja

Makineria të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të mbushet me lehtësi e saktësi me sasinë e nevojshme të pesticidit dhe të sigurojë zbrazje të lehtë dhe të plotë, duke parandaluar derdhjen e pesticidit dhe duke shmangur ndotjen e burimeve ujore gjatë proceseve të tilla.

*5. Aplikimi i pesticideve**5.1 Shkalla e aplikimit*

Makineria të jetë e pajisur me mjete që rregullojnë shkallën e aplikimit pa vështirësi, saktë dhe me besueshmëri.



5.2 Shpërndarja, depozitimi dhe rrjedhja e pesticideve

Makineritë të projektohen dhe ndërtohen për të siguruar që pesticidi është depozituar në zonat e synuara, të minimizojë humbjet në zona të tjera dhe të parandalojë rrjedhjen e pesticideve në mjedis. Kur është e përshtatshme, të sigurohet një shpërndarje e barabartë dhe një depozitim homogjen.

5.3 Testet

Për të verifikuar se pjesët përkatëse të një makinerie janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 5.1 dhe 5.2 të këtij udhëzimi, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet që për çdo lloj të makinerive të kryejë ose të ketë kryer testet e duhura.

5.4 Humbjet gjatë ndalimit

Makineritë të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë humbjet, ndërkohë që funksioni i aplikimit të pesticideve është ndaluar.

6. Mirëmbajtja

6.1 Pastrimi

Makineria të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të lejojë pastrim të lehtë dhe të plotë pa ndotje të mjedisit.

6.2 Mirëmbajtja

Makineria të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të kryhet me lehtësi ndryshimi i pjesëve të konsumuara pa kontaminim të mjedisit.

7. Inspektimet

Lidhja e instrumenteve matëse në makineri duhet të bëhet lehtësisht e mundur për të kontrolluar funksionimin korrekt të makinerisë.

8. Shënimi i sprucatorëve, sitave dhe filtrave

Sprucatorët, sitat dhe filtrat duhet të jenë të shënuar në mënyrë të tillë që lloji dhe madhësia e tyre të mund të identifikohen qartësisht.

9. Tregimi i pesticidit në përdorim

Kur është e përshtatshme, makineria duhet të jetë e pajisur me një pajisje specifike në të cilin operatori mund të vendosë emrin e pesticidit në përdorim.

10. Udhëzimet

Udhëzimet duhet të ofrojnë informacionin e mëposhtëm:

a) masat paraprake që duhen marrë gjatë përzierjes, ngarkimit, aplikimit, zbrazjes, pastrimit, shërbimit dhe transportit në mënyrë që të shmangët kontaminimi i mjedisit;

b) kushtet e detajuara të përdorimit për funksionim në mjedise të ndryshme, duke përfshirë përgatitjet përkatëse dhe rregullimet e nevojshme për të siguruar depozitimin e pesticideve në zonat e synuara dhe minimizuar humbjet në zona të tjera, për të parandaluar rrjedhjen në mjedis dhe kur është e përshtatshme, të sigurojë një shpërndarje të barabartë dhe depozitim homogjen të pesticideve;

c) gamën e llojeve dhe madhësive të sprucatorëve, sitave dhe filtrave që mund të përdoren në makineri;

ç) shpeshtësinë e kontrolleve, kriteret dhe metodat për ndërrimin e pjesëve të konsumuara që ndikojnë në saktësinë e funksionimit të makinerisë, si p.sh. sprucatorë, sitë dhe filtra;

d) specifikimet e kalibrimit, mirëmbajtjen ditore, përgatitjen për dimër dhe të tjera kontrolle të nevojshme për të siguruar saktësinë e funksionimit të makinerisë;

dh) llojet e pesticideve që mund të shkaktojnë funksionimin jokorrekt të makinerisë;

e) një tregues që operatori mban të përditësuar emrin e pesticidit në përdorim në pajisjen specifike të përmendur në pikën 9 të këtij udhëzimi;

ë) lidhjen dhe përdorimin e ndonjë pajisjeje ose aksesori të veçantë, dhe masat e nevojshme që duhen marrë;

f) një tregues që makineria mund të jetë subjekt i kërkesave për inspektim të rregullt nga organet e caktuara, siç parashikohet në Planin e Veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve, miratuar me urdhrin nr. 578, datë 2.12.2022;

g) karakteristikat e makinës të cilat duhet të inspektohen për të siguruar funksionimin korrekt të tij;

gj) udhëzimet për lidhjen e instrumenteve matëse të nevojshme.

11. Certifikimi dhe kontrolli i tij

Mjetet dhe makineritë për aplikimin e PMB-ve në përdorim profesional u nënshtrohen kontrolleve teknike, sipas dispozitave të VKM-së nr. 317, datë 15.5.2019, “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar.

12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 maj 2024.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

UDHËZIM
Nr. 11, datë 2.5.2023

MBI MATERIALET DHE ARTIKUJT
AKTIVË DHE INTELIGJENTË NË
KONTAKT ME USHQIMIN¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton kërkesat specifike për materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë në kontakt me ushqimin të cilat vendosen në treg.

2. Këto kërkesa nuk bien ndesh me aktet e tjera nënligjore që zbatohen për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin, të cilave u shtohen komponentë aktivë ose inteligjentë ose në të cilat ato janë përfshirë, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

3. Për qëllimin e këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “materiale dhe artikuj në kontakt me ushqimin aktiv ose materiale dhe artikuj aktivë” nënkupton materiale dhe artikuj që kanë për qëllim të zgjasin jetëgjatësinë, të ruajnë ose përmirësojnë gjendjen e ushqimit të paketuar; ato janë krijuar për të përfshirë qëllimisht përbërës që çlirojnë ose thithin substanca në/ose nga ushqimi i paketuar ose ambienti që rrethon ushqimin;

b) “materiale dhe artikuj në kontakt me ushqimin inteligjent ose materiale dhe artikuj inteligjentë” nënkupton materiale dhe artikuj që monitorojnë gjendjen e ushqimit të paketuar ose ambientin që rrethon ushqimin;

c) “përbërës”, në kuptim të këtij udhëzimi, nënkupton një substancë të vetme ose një kombinim substancash individuale, që shkaktojnë funksionin aktiv dhe/ose inteligjent të një materiali ose artikulli në kontakt me ushqimin, duke përfshirë produktet e një reaksioni, në vend të këtyre substancave; ai nuk përfshin pjesët pasive, si p.sh. materialin në të cilin shtohen ose bashkohen;

ç) “pengesë funksionale”, nënkupton një pengesë të përbërë nga një ose më shumë shtresa të materialeve në kontakt me ushqimin, e cila siguron që materiali ose artikulli i përfunduar është në përputhje me pikën 6, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” dhe me këtë udhëzim;

d) “materiale dhe artikuj aktivë çlirores” nënkupton ato materiale dhe artikuj aktivë të krijuar për të përfshirë qëllimisht përbërës që do të lëshonin substanca në/ose mbi ushqimin e paketuar ose mjedisin;

dh) “substanca aktive të çliuara” nënkupton ato substanca që synohen të çlirohen nga lëshimi i materialeve dhe artikujve aktivë në/ose mbi ushqimin e paketuar ose mjedisin që rrethon produktin ushqimor dhe përmbushin një qëllim në këtë produkt ushqimor;

e) “substancë aktive dhe/ose inteligjente” nënkupton një substancë që kontribuon në funksionin aktiv dhe/ose inteligjent;

ë) “pjesë pasive” nënkupton të gjithë materialin dhe artikujt në të cilët është shtuar komponenti, si p.sh. kontejneri dhe paketimi parësor në të cilin është vendosur ai komponent ose materiali i paketimit primar në të cilin është shtuar;

f) “mutagen” nënkupton agentët që krijojnë një dukuri të shtuar të mutacioneve në popullatat e qelizave dhe/ose organizmave.

4. Materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë mund të vendosen në treg vetëm nëse ato:

a) janë të përshtatshme dhe efektive për qëllimin e synuar të përdorimit;

b) janë në përputhje me kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në pikën 6, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”;

c) janë në përputhje me kërkesat e veçanta të përcaktuara në pikat 7 deri 10, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”;

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me: Rregullore e Komisionit (KE) nr. 450/2009, e datës 29 maj 2009, “Mbi materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin”.



ç) janë në përputhje me kërkesat e etiketimit të përcaktuara në pikën 13, germa “e”, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”;

d) janë në përputhje me kërkesat e përbërjes të përcaktuara në pikat 5 deri 10 të këtij udhëzimi;

dh) janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara për etiketimin dhe deklarimin në pikat 11 deri 17 të këtij udhëzimi.

5. Vetëm substancat që përfshihen në “listën e substancave të autorizuar” sipas germës “b” të pikës 11, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”, mund të përdoren si përbërës të materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë.

5.1 Substancat e mëposhtme përdoren në përbërës të materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë pa u përfshirë në listën e substancave të autorizuar, sipas pikës 5 të këtij udhëzimi:

a) substancat aktive të çliuara, me kusht që ato të përputhen me kushtet e përcaktuara në pikën 9 të këtij udhëzimi;

b) substancat që përfshihen në objektin e akteve të tjera nënligjore që zbatohen për ushqimin, të cilat shtohen ose futen në përbërje të materialeve dhe artikujve aktivë me teknika të tilla, si transplatimi ose bllokimi, në mënyrë që të kenë efekt teknologjik në ushqim, me kusht që ato të përputhen me kushtet e përcaktuara në pikën 9 të këtij udhëzimi;

c) substancat e përdorura në përbërës që nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin ose mjedisin përreth ushqimit dhe janë të ndara nga ushqimi nga një pengesë funksionale, me kusht që ato të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 10 të këtij udhëzimi dhe që të mos përfshihen në asnjërin nga kategoritë e mëposhtme:

i. substanca të klasifikuara si “mutagjene” dhe “kancerogjene”;

ii. substancat e projektuara qëllimisht në madhësinë e grimcave të cilat shfaqin veti funksionale fizike dhe kimike që ndryshojnë dukshëm nga ato në një shkallë më të madhe.

6. Për t'u përfshirë në listën e substancave të autorizuar, substancat që përdoren në përbërës të materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë duhet të plotësojnë kërkesat e pikës 6, dhe kur ato janë të zbatueshme, kërkesat e pikave 7 deri në 10, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për

materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”, për kushtin e synuar të përdorimit të materialit ose artikullit aktiv ose inteligjent.

7. Lista e substancave të autorizuar përcakton:

a) identitetin e substancës;

b) funksionin e substancës;

c) numrin e referencës;

ç) nëse është e nevojshme, kushtet e përdorimit të substancës ose përbërësit;

d) nëse është e nevojshme, kufizimet dhe/ose specifikimet e përdorimit të substancës;

dh) nëse është e nevojshme, kushtet e përdorimit të materialit ose artikullit, në të cilin substanca ose përbërësi është shtuar ose në të cilin është përfshirë.

8. Substancat aktive të çliuara, siç përmenden në pikën 5.1, germa “a” të këtij udhëzimi dhe substancat e shtuara ose të future në përbërje me teknika të tilla, si transplatimi ose bllokimi, siç përmendet në pikën 5.1, germa “b” të këtij udhëzimi, do të përdoren në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse të zbatueshme për ushqimin dhe të jenë në përputhje me udhëzimin nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” dhe kur është e aplikueshme, masat zbatuese të saj.

8.1 Sasia e një lënde aktive të çliuar nuk do të përfshihet në vlerën e migrimit të përgjithshëm të matur, në rastet kur kufiri i përgjithshëm i migrimit është vendosur në një masë specifike për materialin në kontakt me ushqimin në të cilin përbërësi është i përfshirë.

8.2 Pa rënë ndesh me pikën 9, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”, sasia e një lënde aktive të çliuar mund të tejkalojë kufirin specifik të vendosur për atë substancë në një masë specifike kombëtare për materialet në kontakt me ushqimin, në të cilat përbërësi është i përfshirë, me kusht që të jetë në përputhje me dispozitat e zbatueshme për ushqimin.

9. Migrimi i substancave në ushqim, nga përbërësit që nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin ose mjedisin që rrethon ushqimin, siç përmendet në pikën 5.1, germa “c” të këtij udhëzimi, nuk duhet të kalojë 0,01 mg/kg.

10. Kufiri i parashikuar në pikën 9 të këtij udhëzimi, do të shprehet gjithmonë si përqendrim në ushqime. Ai do të zbatohet për një grup substancash, nëse kanë lidhje strukturore dhe

toksikologjike, të lidhura, në veçanti izomerët ose substancat me të njëjtin grup funksional përkatës, dhe do të përfshijë transferimin e mundshëm të kompensimit.

11. Për të lejuar identifikimin nga konsumatori të pjesëve jo të ngrënshme, materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë ose pjesët e tyre do të etiketohen sa herë që perceptohen si të ngrënshme:

a) me fjalët “MOS HA”, dhe;

b) me simbolin e përcaktuar në shtojcën I të këtij udhëzimi, nëse është e mundur teknikisht.

12. Informacioni i kërkuar në pikën 11 të këtij udhëzimi, duhet të jetë i dukshëm, i qartë, i lexueshëm dhe mos të ketë mundësi fshirje apo ndryshimi. Ai do të shtypet në karaktere të një madhësie shkrimi prej të paktën 3 mm dhe duhet të përputhen me kërkesat e përcaktuara në pikat 13 deri në 20, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”.

13. Substanca aktive e çliruar do të konsiderohet si përbërës sipas kuptimit të pikës 33, neni 3 “Përkufizime” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.7.2018, “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” dhe do t’u nënshtrohet dispozitave të kësaj VKM-je.

14. Në fazat e tregtimit, të ndryshme nga shitja te konsumatori i fundit, materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë, pavarësisht nëse janë apo jo në kontakt me ushqimin, apo përbërësit e destinuar për prodhimin e atyre materialeve dhe artikujve ose substancat e destinuara për prodhimin e këtyre përbërësve, duhet të shoqërohen nga një deklaratë me shkrim në përputhje me pikën 21, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”.

15. Deklarata e përmendur në pikën 14, lëshohet nga operatori i biznesit dhe do të përmbajë informacionin e përcaktuar në shtojcën II të këtij udhëzimi.

16. Dokumentacioni i përshtatshëm për të demonstruar se materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë dhe përbërësit e synuar për prodhimin e këtyre materialeve dhe artikujve përputhen me kërkesat e këtij udhëzimi, do të vihen në dispozicion nga operatori i biznesit tek Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sipas kërkesës.

17. Dokumentacioni do të përmbajë informacion mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e materialit ose artikullit aktiv ose inteligjent,

kushtet dhe rezultatet e testimit ose llogaritjeve ose analizave të tjera dhe prova mbi sigurinë ose arsyetimin që demonstroi përputhshmërinë.

18. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit merr masat e nevojshme për informimin e operatorëve të biznesit.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 dhjetor 2023.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA I SIMBOLI



SHTOJCA II DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

Deklarata me shkrim e përmendur në pikën 14 të këtij udhëzimi, përmban informacionin e mëposhtëm:

1. Identitetin dhe adresën e operatorit të biznesit i cili lëshon deklaratën e përputhshmërisë;

2. Identitetin dhe adresën e operatorit të biznesit që prodhon ose importon materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë, ose përbërësit e destinuar për prodhimin e këtyre materialeve dhe artikujve, ose substancave të destinuara për prodhimin e komponentëve;

3. Identitetin e materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë ose përbërësve të destinuar për prodhimin e këtyre materialeve dhe artikujve, ose substancave të destinuara për prodhimin e komponentëve;



4. Datën e deklaratës;

5. Konfirmimin se materiali ose artikulli aktiv ose inteligjent përputhet me kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim, udhëzimin nr. 15, datë 13.12.2012, “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin” dhe me masat specifike të zbatueshme;

6. Informacionin e përshtatshëm në lidhje me substancat që përbëjnë komponentët, për të cilat ekzistojnë kufizime sipas dispozitave kombëtare të zbatueshme për ushqimin dhe këtij udhëzimi; aty ku është e përshtatshme, kriteret specifike të pastërtisë në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm për ushqimin dhe emrin dhe sasinë e substancave të çliuara nga përbërësi aktiv, për të lejuar operatorët e biznesit të sigurojnë përputhshmërinë me këto kufizime.

7. Informacion e përshtatshëm mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e materialit ose artikullit aktiv ose inteligjent;

8. Specifikimet për përdorimin e komponentit, të tilla si:

i. grupin ose grupet e materialeve dhe artikujve në të cilët përbërësi mund të shtohet ose të përfshihet;

ii. kushtet e përdorimit të nevojshme për të arritur efektin e synuar;

9. Specifikimet për përdorimin e materialit ose artikullit, të tilla si:

i. llojin ose llojet e ushqimit që synohet të vihet në kontakt me të;

ii. kohën dhe temperaturën e trajtimit dhe ruajtjes në kontakt me ushqimin;

iii. raportin e sipërfaqes së kontaktit me ushqimin me vëllimin e përdorur për të përcaktuar përputhshmërinë e materialit ose artikullit;

10. Kur përdoret një pengesë funksionale, konfirmimi që materiali ose artikulli aktiv ose inteligjent përputhet me pikat 9 dhe 10 të këtij udhëzimi.

Deklarata me shkrim do të lejojë një identifikim të lehtë të materialeve dhe artikujve aktivë dhe inteligjentë ose të përbërësit, ose të substancës për të cilën është lëshuar dhe do të rinovohet, kur ndryshime thelbësore në prodhim sjellin ndryshime në megrim, ose kur ka të dhëna të reja shkencore.

UDHËZIM

Nr. 55, datë 27.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË SHITJES DHE DEPOZITIMIT TË TË ARDHURAVE NGA SHITJA E PASURIVE TË SEKUESTRUARA, TË CILAT DËMTOHEN, U BIE VLERA NË MËNYRË TË NDJESHME OSE DALIN JASHTË PËRDORIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 19, të ligjit nr. 10192/2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për zhvillimin e ankandit nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (në vijim “AAPSK”), për shitjen e sendeve dhe depozitimin e të ardhurave nga shitja e pasurive të sekuestruara, të cilat mund të dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose me kalimin e kohës dalin jashtë përdorimit, për të garantuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor për kalimin e të drejtave të pronësisë për pasuritë e sekuestruara, si dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

2. Administratori pasurisë i paraqet kryeadministratorit një raport tekniko-financiar dhe kërkesë të arsyetuar, për vijimin e procedurave të ankandit, me qëllim nxjerrjen në shitje të pasurive mbi të cilat nuk rëndon asnjë barrë apo detyrim.

3. AAPSK-ja, gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit, udhëhiqet nga parimet:

- a) e ligjshmërisë;
- b) e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit;
- c) e transparencës;
- ç) e garantimit të procesit të rregullt ligjor.



4. Kryeadministratori krijon njësinë e ankandit, detyrat e përgjegjësitë e së cilës përkufizohen në rregullat e ankandit publik. Kjo njësi përbëhet nga të paktën 3 anëtarë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist.

Njësia e ankandit, është përgjegjëse për realizimin e ankandit në përputhje me dispozitat e legjislacionin në fuqi për ankandet publike dhe të këtyre rregullave.

5. AAPSK-ja detyrohet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të ankandit, në mënyrë të tillë që të mundësojë kontrollin e ligjshmërisë së procedurës nga strukturat kompetente shtetërore, të cilat ligji i autorizon të mbikëqyrin ankandet.

6. Në bazë të parimit të mosdiskriminimit, AAPSK-ja duhet të shmangë çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që përbën diskriminim ndaj ose ndërmjet kandidatëve blerës apo ndaj kategorive të tyre.

7. AAPSK-ja refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrjen në procedurën e shitjes me ankand publik nëse:

a) ofertuesi apo kandidati blerës i jep ose premtun t'i japë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, funksionarëve publik, që marrin pjesë në procedurën e ankandit, një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë që ndërmerr për procedurën e ankandit;

b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit. Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë pasqyrohen në procesverbalet e procedurave të ankandit dhe i komunikohen menjëherë e zyrtarisht, kandidatit ose ofertuesit në fjalë. Në këtë rast, AAPSK-ja kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale, bën kallëzim penal, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

8. I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për ankandet publike dhe në këtë udhëzim bëhen ose dokumentohen me shkrim dhe janë pjesë e praktikës shkresore që administrohet nga AAPSK-ja.

Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhet në mënyrë të tillë, që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave,

konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

9. AAPSK-ja vendos në dispozicion të çdo personi që ka interes të ligjshëm e të drejtpërdrejtë nga procedura e ankandit, me kërkesë të tij, pasi është përcaktuar oferta fituese apo pasi procedurat e ankandit kanë përfunduar pa përcaktuar një fitues, informacionin e administruar për çdo ankand, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

10. Në çdo rast, AAPSK-ja vë në dijeni menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit:

a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në ankand;

b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;

c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për karakteristikat dhe përparësitë e ofertës së përzgjedhur.

10/1. Përfashtim nga e drejta për informim bëhet vetëm në rast se dhënia e informacionin vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale ose cenon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

10/2. AAPSK-ja nuk i bën publike informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuara si konfidenciale, ku veçanërisht përfshihet informacioni për aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

II. PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Pasi administron pasurinë e sekuestruar dhe pasi vlerëson se sendi mund të dëmtohet, i bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose me kalimin e kohës del jashtë përdorimit, AAPSK-ja nëpërmjet një vlerësuesi të licencuar dhe një strukture të ngritur për këtë qëllim, përcakton me vendim vlerën e sendit, bazuar në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e sekuestrimit të tij.

2. Pas vlerësimit të sendit të sekuestruar, AAPSK-ja i kërkon pronarit të këtij sendi, të shprehë dakordësinë për çmimin e përcaktuar nga vlerësuesi. Nëse brenda një jave nga njoftimi, AAPSK-ja dhe pronari i sendit nuk arrijnë marrëveshjen, AAPSK-ja vijon me procedurën e ankandit.

3. Brenda 15 ditëve nga përcaktimi i çmimit të sendit, AAPSK-ja, për shitjen e sendit në ankand,



bën njoftimin publik në faqen e internetit të saj dhe e dërgon për botim në Buletin e Njoftimeve Publike, në përputhje me nenin 23, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar.

4. AAPSK-ja, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e objektit të ankandit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga shpallja e ankandit.

5. Shpallja për shitjen në ankand shoqërohet edhe me informacionin, për:

- a) sendin që do të shitet;
- b) vendin, adresën dhe afatin e fundit kohor, për paraqitjen e ofertave dhe dorëzimin e dokumenteve të ankandit;
- c) të dhënat e nevojshme për të kontaktuar strukturën e AAPSK-së përgjegjëse për zhvillimin e ankandit;
- ç) gjuhën/gjuhët, në të cilën/at duhet të hartohen ofertat;
- d) mënyrën dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të ankandit;
- dh) orën dhe datën e hapjes së ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

6. Informacioni për sendin që do të shitet në ankand përmban karakteristikat e sendit, duke e përshkruar atë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Informacioni për sendin që do të shitet në ankand:

- a) duhet t’i referohet vendimit gjyqësor për sekuestrimin e sendit;
- b) duhet të përshkruajë sendin në përputhje me standardet e vlerësimit sipas sasisë, çmimit për njësi dhe çmimit në total, metodologjisë së përdorur për vlerësimin e sendit të shitjes;
- c) duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, me genplane, planimetri të objektit, vizatime, modele, makete, mostra, fotografi, analiza kimike dhe dokumente të ngjashme;
- ç) duhet të përshkruajë gjendjen funksionale të sendit nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.

d) duhet të përshkruhet qartë, duke iu referuar aktit të pronësisë mbi objektin apo aktit ligjor të disponibilitetit të tij.

7. AAPSK-ja është përgjegjëse për ankandin, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ankandet publike dhe në këtë udhëzim.

8. Modeli standard i shpalljes për shitjen në ankand, informacionit që shoqëron shpalljen dhe dokumenteve të tjera të ankandit përpilohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankandet publike.

III. ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Procedura e përzgjedhur për ankandin përcaktohet në përputhje me nenet 18–23, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesit nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me AAPSK, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Secili ofertues që merr pjesë në ankand nëpërmjet paraqitjes së ofertës, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci, në llogarinë e përcaktuar nga AAPSK-ja, një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje.

4. AAPSK-ja kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues, vetëm nëse:

- a) jep ofertën dhe ankandin brenda afatit të përcaktuar në shpalljen për shitjen në ankand;
- b) paraqet formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet e ankandit;
- c) paraqet dokument identifikimi;
- ç) kandidati ose ofertuesi është person juridik, paraqet, sipas rastit:
 - i. vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
 - ii. certifikatën e regjistrimit në organet tatimore ose NIPT-in.

5. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim për ofertën ndërmjet punonjësve të AAPSK-së dhe ofertuesve. AAPSK-ja nuk ka të drejtë t’u kërkojë ofertuesve të ndërmarrin përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e ankandit, apo të ndryshojnë vlerën e ofertës ose ta modifikojnë në çfarëdo mënyre atë.

6. Shitja e sendit bëhet në ambientet e AAPSK-së ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit dhe që



është njoftuar në shpalljen e shitjes në ankand. Ajo vazhdon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

7. Njësia e Ankandit i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati.

7/1. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga AAPSK-ja, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së ankandit.

8. Procesverbalin duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

9. Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesi shënon, kundrejt nënshkrimit, çmimin që jep për sendin, pavarësisht nga çmimi që ka dhënë më parë. Në rast se ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet dhe të shënohet në procesverbal edhe prokura noteriale.

Nëse është e nevojshme, njësia e ankandit kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në procesverbalin e ankandit.

10. Pas përfundimit të seancës publike, njësia e ankandit verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat ligjore. Nëse njësia e ankandit gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni pjesëmarrësit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertës dhe kualifikimi përfundimtar. Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 10 (dhjetë) ditë.

11. Njësia e ankandit, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

11/1. Megjithatë, njësia e ankandit duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi, duke njoftuar menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.

12. Njësia e ankandit vlerëson se oferta është e vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në shpalljen për shitjen në ankand dhe në dokumentet e ankandit.

13. AAPSK-ja vlerëson se një ofertë është e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, apo gabime të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

14. Njësia e ankandit nuk e pranon një ofertë kur:

a) ofertuesi nuk është i kualifikuar;

b) ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik;

c) oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e ankandit;

ç) në rastet e refuzimit apo të skualifikimit, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

15. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të ofertave, njësia e ankandit vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet të paktën një ofertë e vlefshme.

16. Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.

Njësia e ankandit përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

AAPSK-ja shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka vlerën më të lartë.

17. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë, si dhe ofertuesve të tjerë të suksesshëm. Njoftimi i fituesit përmban:

a) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe vlerën e ofruar prej tij;

b) emrat e ofertuesve pjesëmarrës dhe vlerat e ofertave të tyre;



c) emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

ç) vlerat e ofertave.

17/1. Njoftimi i fituesit shpallet në faqen e internetit të AAPSK-së dhe botohet në Buletin e Njoftimeve Publike.

18. Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave, organizohet ankandi i dytë për shitjen e sendit me të njëjtin çmim dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla si për ankandin e parë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ankandet publike dhe në këtë udhëzim.

18/1. Në rast se edhe në ankandin e dytë nuk paraqitet asnjë ofertues, AAPSK-ja i paraqet dokumentacionin e plotë Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, i cili shprehet për vijimin e mëtejshëm të procedurës apo ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurisë.

IV. PËRFUNDIMI I PROCEDURËS SË ANKANDIT

1. Pas përcaktimit të ofertuesit fitues, kryeadministratori njofton menjëherë blerësin që të paguajë çmimin e sendit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mbarimi i procedurës së ankandit.

2. Të ardhurat nga shitja e pasurive të sekuestruara, të cilat mund të dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose me kalimin e kohës dalin jashtë përdorimit, depozitohen në llogarinë e AAPSK-së.

3. Me pagimin e çmimit kryeadministratori merr vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit, të cilin ia njofton blerësit.

4. Blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitor nga momenti i nxjerrjes së vendimit për kalimin e sendit në pronësi nga kryeadministratori apo personi i autorizuar prej tij, i cili është i detyruar të vërë në posedim të blerësit sendin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga pagimi i çmimit të sendit.

5. Blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ankandet dhe në këtë udhëzim.

V. ANKIMIMI

1. Kundër veprimeve të njësisë së ankandit dhe kryeadministratorit, të kryera gjatë procedurës së ankandit, mund të bëhet ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes, në gjykatën kompetente.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR
Nr. 66, datë 28.4.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. Arlinda Drenofci.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 8.5.2023 deri më datë 19.5.2023.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Arlinda Drenofci.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim



VENDIM
Nr. 431, datë 3.5.2023

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU
SHKODËR, Z. FRROK GJIN GJINI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ÿ”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1072/1 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Benet Bahri Beci, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 69, datë 15.2.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 410, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese

në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, ka fituar 3 (tri) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 410, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi rezulton, se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 05 (pesë), z. Frrok Gjin Gjini.

Me shkresën nr. 3777 prot, datë 13.4.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, z. Frrok Gjin Gjini, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

